



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 66, datë 22.12.2022

**PËR RISHIKIMIN E VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT
TË KANDIDATURËS SË Znj. HOLTA ZAÇAJ**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare
Anila Leka	Anëtare relatores
Elsa Toska	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Mema	Anëtare

Asistuar nga sekretare Fabiola Muhameti, me praninë e Avokatit të Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mbledhjen e datës 22.12.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT:

Holta Zaçaj

OBJEKTI:

Rishikimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës znj. Holta Zaçaj.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e zëvendëskryetares së KED-së, znj. Marsida Xhaferllari, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokati i Popullit, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në

mbledhjet dhe veprimtarinë e KED-së, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. KED, me vendimin nr. 22, datë 20.7.2022 ka vendosur *“Lejimin e kandidimit të kandidates Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtares Vitore Tusha”*. Procedura e mëtejshme e vlerësimit dhe e pikëzimit për kandidatët për këtë vakancë u ndërpre për periudhën 14.10.2022 – 5.12.2022, nga KED për shkak të mbetjes së vetëm 2 kandidatëve, pra të rënies së numrit të kandidaturave nën 3 dhe rishpalljes së vakancës nga Gjykata e Lartë.
2. Ndërkohë, KED ka zhvilluar dhe përfunduar procedurën e verifikimit, vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidaturave për vendin vakant të gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarit Gani Dizdari, ku kandidonte edhe kandidatja Holta Zaçaj. Për efekt të kësaj procedure, KED, me vendimin nr. 34, datë 11.8.2022 (vendimi nr. 34/2022), ka vendosur vlerësimin e kandidates Holta Zaçaj me 82,2 (tetëdhjetë e dy presje dy) pikë. Në këtë vendim, në rubrikën *“Kualifikime Pasuniversitare”*, KED ka arsyetuar si vijon:

“18. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

19. Referuar kritereve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjëjnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.

20. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen,

fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

21. *Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka ndjekur studimet “Master i Ligjeve” (LL.M) në Universitetin Georgetown Washington D.C., periudha Shtator 2007-Maj 2008, Student Fulbright. Për këtë cikël studimi është paraqitur diploma e njësuar me origjinalin dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, për të cilën kandidatja nuk ka kërkuar njohjen e titullit të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.*

22. *Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit Tituj, grada, shkolla e magistraturës etj., Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Holta Zaçaj, me **0,55 (zero presje pesëdhjetë e pesë) pikë.***

23. *Për treguesin e vlerësimit “Trajnimet e tjera”, vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, duke mbajtur parasysh edhe numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi. Lidhur me këtë kriter vlerësimi, Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.*

24. *Nga kandidatja është paraqitur dokumentacion mbështetës, kopje e njësuar me origjinalin, për kualifikimet/trajnimet e mëposhtme:*

- *Kualifikim: Kualifikim për bazat e legjislacionit amerikan dhe edukimit ligjor*

Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Georgetown, Washington DC, USA

Periudha: 8 Korrik-4 Gusht 2007

- *Trajnim: Tema “Ligji për refugjatët dhe Praktika”*

Institucioni: UNHCR

Periudha: 26-28 Korrik 2001

Praktikë/internship: Praktikë në Gjykatën e Shkallës së Parë në Paris

Periudha: 26 Mars-25 Maj 2001

- *Trajnim: Mbi teknikat e hartimit të legjislacionit*

Institucioni: ORT/USAID

Periudha: Shkurt-Mars 1999

- *Trajnim: Databaza e Klinikës Ligjore (i papërmendur në jetëshkrim)*

Institucioni: Eorld Learning

Periudha: 5-10 Shkurt 2001

Për kualifikimin vijues është paraqitur nga kandidatja kopje jozyrtare:

- *Kualifikim: Në të drejtën kushtetuese*
Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Suffolk, Massachusetts, USA
Periudha: Janar-Maj 2018

Gjithashtu, nga kandidatja është deklaruar në jetëshkrim pjesëmarrja në trajnimet vijuese, pa u paraqitur dokumentacion provues:

- *Trajnim: Kurs trajnimi për demokraci dhe zhvillim*
Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Stanford, California, USA
Periudha: Korrik-Gusht 2006
- *Trajnim: Për menaxhimin e programeve të klinikave ligjore*
Institucioni: Komiteti Hungarez i Helsinkit
Periudha: Shtator 2003-Dhjetor 2004
- *Trajnim: Për qasjen pedagogjike të trajnerëve të profesionistëve të nivelit të lartë në Shkollën e Magjistraturës, Shqipëri*
Institucioni: Këshilli i Evropës
Periudha: Mars-Prill 2003
- *Trajnim: Programi i vizitorëve ndërkombëtarë në Departamentin e Shtetit, USA*
Periudha: Qershor-Korrik 2002
- *Trajnim: Mbi të Drejtat e Njeriut*
Institucioni: Komiteti Hollandez i Helsinkit dhe Ministria e Punëve të Jashtme Hollandeze, Utrecht, Hollandë
Periudha: 5 Qershor-17 Korrik 1999

*25. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e jetëshkrimit të kandidatit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si dhe duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Holta Zaçaj, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1,77 (një presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.”.*

3. Në datën 5.12.2022, KED pas marrjes së njoftimit nga Gjykata e Lartë se në procedurën e rishpalljes së vendit vakant nuk kishte shprehur interes asnjë kandidat tjetër, vendosi të përfundojë procedurën e vlerësimit dhe të pikëzimit të vakancës për shkak të mbarimit të gjyqtares Vitore Tusha me dy kandidatët e mbetur në garë. Në të njëjtën mbledhje, KED vlerësoi të konsiderojë kandidaten Holta Zaçaj të pikëzuar në kushtet kur të dhënat dhe treguesit e saj ishin realizuar për vakancën tjetër, nga KED-ja me të njëjtën anëtarësi dhe koha e kaluar nga ky pikëzim nuk ishte e konsiderueshme në drejtim të ndryshimit të rrethanave që ndikonin në pikëzim.
4. Në datën 30.11.2022, pranë sekretarisë së KED-së është depozituar kërkesa me shkrim, e protokolluar në KED me nr. 654 prot., datë 30.11.2022, me anën e së cilës,

kandidatja Holta Zaçaj ka bërë me dije se ka kryer procesin e ekuivalentimit të diplomës së Masterit të kryer pranë Georgetown University, SHBA, duke bashkëngjitur dhe dokumentin e ekuivalentimit të diplomës përkatëse të Masterit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Me Vërtetimin Njohje dhe Vlerësim, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Komisioni i Njohjes së Diplomave, i cili mban nr. prot. 3745/3, nr. regjistri 606, datë 25.11.2022, vërtetohet njohja e diplomës së Znj. Holta Vladimir Kotherja Zaçaj, lëshuar nga Universiteti Georgetown, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 18.8.2008, me kohëzgjatje zyrtare 1 – vjeçare, me kohë të plotë, në Drejtësi për Letrat me Vlerë dhe Rregulloren Financiare. Kjo diplomë njehet si **Master i Shkencave** në Republikën e Shqipërisë.

5. Në datat 5 dhe 16 dhjetor 2022, kandidatja Holta Zaçaj ka dërguar me postë elektronike pranë Sekretarisë KED, kërkesa për rishikimin e pikëzimit të kandidatës së saj pas dorëzimit të aktit të Njohjes dhe Njehsimit të Diplomës së Masterit Shkencor. Ajo ka parashtruar: *“Në kuadër të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatës sime për vakancën e mandatit të gjyqtares, znj. Vitore Tusha, të mos merret për bazë vlerësimi dhe pikëzimi që i është bërë kandidatës sime për vakancën e gjyqtarit, z. Gani Dizdari, por në zbatim të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Metodologjia për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese” të bëhet vlerësimi dhe pikëzimi im edhe për kualifikimin pasuniversitar, mbi bazën e dokumentacionit të ri të sipërcituar, të paraqitur pranë KED-së, në kuadër të rishprehjes së interesit tim për këtë vakancë.”*.
6. KED në mbledhjen e datës 21.12.2022 shqyrtoi kërkesën e kandidates Holta Zaçaj bazuar në nenet 144 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative dhe konstatoi se në pikëzimin e saj, 7 prej 9 anëtarëve të KED-së kishin dhënë vlerësimin zero pikë për titujt akademikë. Në këtë situatë, KED vlerësoi se aktet e paraqitura prej saj përbënin provë të re mbi rrethanën e titujve akademikë të saj, e cila sipas Metodologjisë për Vlerësimin dhe Caktimin e Pikëve për Renditjen e Kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ndikon në rezultatin e pikëve të kandidates. Për rrjedhojë, KED vendosi që në mbledhjen e radhës ta analizojë këtë provë të re në raport me pikëzimin e kandidates në drejtim të titujve akademikë, duke urdhëruar edhe hartimin e një relacioni shtesë.
7. Mbledhja e KED-së u zhvillua në datën 22.12.2022, ora 17:00, ku u shqyrtua çështja me objekt rishikimin e vlerësimit të kandidates Holta Zaçaj, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtares Vitore Tusha.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

8. Në rubrikën “Kualifikime Pasuniversitare”, KED rishikon vlerësimin e mëparshëm të kryer në vendimin nr. 34, datë 11.8.2022 dhe arsyeton si vijon:

9. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
10. Referuar kritereve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.
11. KED-ja vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.
12. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të paraqitur rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka ndjekur studimet “Master i Ligjeve” (LL.M) në Universitetin Georgetown Washington D.C., periudha Shtator 2007-Maj 2008, Student Fulbright. Me Vërtetimin Njohje dhe Vlerësim, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Komisioni i Njohjes së Diplomave, i cili mban nr. prot. 3745/3, nr. regjistri 606, datë 25.11.2022, vërtetohet njohja e diplomës së Znj. Holta Vladimir Kotherja Zaçaj, lëshuar nga Universiteti Georgetown, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 18.8.2008, me kohëzgjatje zyrtare 1 – vjeçare, me kohë të plotë, në Drejtësi për Letrat me Vlerë dhe Rregulloren Financiare. Kjo diplomë njësohet si **Master i Shkencave** në Republikën e Shqipërisë.
13. Në ligjin nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VII, “Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”, në pikat 1 dhe 2 të nenit 69, “Format e studimeve dhe pranimit në institucionet e arsimit të lartë”, parashikohet se: “1. Format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë janë: a) studime me kohë të plotë; b) studime me kohë të zgjatur. 2. Studimet me kohë të zgjatur mund të ofrohen në programet e studimit një deri në dyvjeçare me karakter profesional, programet e

ciklit të dytë "Master profesional" dhe programet e ciklit të tretë "Master ekzekutiv". Programet e studimit, që japin të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, organizohen vetëm në formën e studimeve me kohë të plotë...".

14. Në nenin 75, "Programet e ciklit të dytë të studimeve", parashikohet se: *"1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit "Master i shkencave", "Master i arteve" dhe "Master profesional", referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. 2. Të gjitha kriteret dhe modalitetet e fitimit të diplomave "Master i arteve" janë të njëjta me ato për fitimin e diplomës "Master i shkencave", me ndryshimin që diploma "Master i arteve" lëshohet nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë formime në fushën e arteve. 3. Programet e studimit "Master i shkencave" pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike; b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë...".*
15. Ndërsa në nenin 77, "Programet e ciklit të tretë të studimeve", parashikohet se: *"1. Cikli i tretë i studimeve përfshin programet e studimeve "Master ekzekutiv", programet e studimeve specializuese afatgjata, si dhe studimet e doktoratës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. 2. Programet e studimeve "Master ekzekutiv" ofrojnë arsimim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional. Ato kanë kohëzgjatje normale një ose dy vite akademike dhe organizohen përkatësisht me 60 ose 120 kredite. Ato përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma "Master ekzekutiv" në fushën e arsimimit të kryer. 3. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta. Ato zgjasin jo më pak se dy vite akademike dhe organizohen me jo më pak se 120 kredite. Ato përmbyllen me provim formimi ose me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë specializimi" në fushën përkatëse të programit të studimit. 4. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësi bazë ose njësi kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor". Institucionet e arsimit të lartë vendosin kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor...".*
16. Në Kreun XIII, "Dispozita kalimtare dhe të fundit", në nenin 124, pikat 1-6, parashikohet se: *"1. Diplomat e programeve të studimit, që kanë zgjatur 3 vite (6*

semestra), janë ekuivalente me diplomat "Bachelor". 2. Diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku, 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat "Master i shkencave". 3. Diplomat për programet e integruara të nivelit të dytë (DIND), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave". Diplomat e nivelit të dytë (DND), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave". 4. Diplomat e programeve të studimit, "Master i nivelit të parë" janë ekuivalente me diplomat "Master profesional". 5. Diplomat e fituara në studimet në kuadër të "Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara" dhe "Master i nivelit të dytë" janë ekuivalente me diplomat "Master ekzekutiv". 6. Diplomat e fituara në kuadër të Shkollës së Magjistraturës janë ekuivalente me diplomat e studimeve të specializimeve afatgjata...".

17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit tituj akademikë, grada, shkolla e magjistraturës etj., Këshilli çmoi të rishikojë vlerësimin për kandidaten Holta Zaçaj, duke e rivlerësuar atë me **3,05 (tre presje zero pesë) pikë**. Pjesa tjetër e vlerësimit që KED i ka bërë kandidaturës së Znj. Holta Zaçaj më vendimin nr. 34, datë 11.8.2022, mbetet e pandryshuar.
18. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet në total me **84,72 (tetëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e dy) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 " Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe të shkronjës "a" të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019, "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", si dhe në nenet 144 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi:

VENDOSI:

1. Rishikimin e vendimit nr. 34, datë 11.8.2022, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidates Holta Zaçaj, si më poshtë:

Vlerësimin e kandidates Holta Zaçaj, me **84,72 (tetëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë e dy) pikë** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 16.01.2017 dhe rishpallur në datat 03.06.2022, 31.01.2022 dhe 28.10.2022.

2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Holta Zaçaj.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAKU

